



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Datë: 27.02.2025
Numër Protokolli: 1596/2025

A.nr.74/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.74/2025 të datës 13.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.Rr., kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.74/2025, e datës 13.01.2025, e parashtruar nga ankuesi F.Rr.

II. Anulohet në tersi konkursi me Nr. Reference: RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektoratit i Punës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke publikuar Njoftimin për anulimin e konkursit të përcaktuar si në pikën **II** të dispozitivit, brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimi të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, F.Rr.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 13.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 134/2025, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.74/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 27.10.2024, mbi të cilin akt i është refuzuar aplikacioni, për Konkursin me numër reference RN00015136, i shpallur me datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, për tetë (8) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesat për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa ky i fundit më datë 03.02.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 134/2025, të datës 13.01.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Kërkesë për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2025; Vendimin me numër protokoli 2430 i datës 13.09.2024 për shpalljen e konkurseve për Inspektor të Punës; Konkursin me numër Reference RN00015136 të datës 13.09.2024; Vendimin me numër protokoli 3049 të datës 18.11.2024 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Akt Emërimet dhe Vendimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve; Vendimin e datës 27.10.2024; Fletë aplikimin e datës 16.09.2024, të ankuesit; Fletë aplikimin e datës 27.09.2024, të F.B; Fletë aplikimin e datës 12.10.2024, të A.Xh; Fletë aplikimin e datës 07.10.2024, të M.M; Njoftimin e datës 15.11.2024; Formularin e renditjes përfundimtare; Njoftimin me numër protokoli 3380 të datës 24.12.2024 për shpalljen e kandidatëve fitues.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 13.09.2024 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00015136, për tetë (8) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.09.2024 deri më 13.10.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 169 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 91 kandidatë, rrjedhimisht nga këto shkresa rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili sipas Vendimit të datës 27.10.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është njoftuar se aplikacioni i tij është refuzuar me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mbi vërtetimin e përvojës së punës të kërkuar me shpalljen e konkursit përkatës, duke mos plotësuar kështu kushtet e konkursit për të kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, më datë 24.12.2024 ka publikuar Njoftimin me numër protokoli 3380, për shpalljen e kandidatëve fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati F.B me gjithsejtë 82.8 pikë të arritura, kandidati A.Xh me gjithsejtë 79.4 pikë të arritura dhe kandidatja M.M me gjithsejtë 71.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë fitues për pozitat e punës *Inspektor i Punës* pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon vendimi mbi refuzimin e aplikacionit të tij është nxjerrë mbi konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, trajtimit të pa barabartë (diskriminimin) dhe shkeljeve të dispozitave ligjore, duke theksuar ndër të tjera se ka dorëzuar gjithë dokumentacionin për vërtetimin e përvojës së punës të kërkuar sipas shpalljes së konkursit, gjegjësisht pasqyrën e kursimeve pensionale, dhe po ashtu ka deklaruar se në procedurën përkatëse të rekrutimit janë përdorur standarde të dyfishta sipas preferencave dhe jo sipas gjendjes faktike nga persona jo kompetent që kanë shpallur dhe zhvilluar të njëjtin konkurs, duke kërkuar që të aprovohet si e bazuar ankesa dhe të anulohet konkursin në fjalë.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka shqyrtuar në tërësi procedurën e pranimit

sipas konkursit me Nr. referencës RN00015137 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt sipas konkursit të shpallur me datë 13.09.2024 me shifër RN00015137, duke filluar nga iniciimi për shpalljen e konkursit deri në njoftimin për kandidatët fitues.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se sipas Vendimit me numër protokoli 2430 të datës 13.09.2024 të nxjerr nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, i njëjti ka obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës që të bëjë shpalljen dhe zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitat e lira për Inspektor të Punës në rajonin e Prishtinës me 21 pozita, Rajonin e Mitrovicës me 4 pozita, Rajonin e Pejës me 7 pozita, Rajonin e Prizrenit me 8 pozita, Rajonin e Ferizajt me 7 pozita, Rajonin e Gjilanit me 6 pozita dhe Rajonin e Gjakovës me 7 pozita, ndërsa konkursi është shpall në të njëjtën ditë.

Tutje Kolegji i Këshillit, sipas provave materiale të çështjes konstaton se Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës me datës 18.11.2024 ka nxjerr Vendim me numër protokoli 3049 me të cilin ka bërë themelimin e Komisionit të Presimit për vlerësimin profesional të kandidateve për konkurse për Inspektor të Punës në regjionet e cekura si më lartë, në përbërje: Kryetar-A.Ç, zëvendësues-B.L, anëtar-P.V, zëvendësues A.O, anëtare-Gj.Q, zëvendësues-S. H, anëtar-N.Sh, zëvendësues-K.S, anëtar-F.F, zëvendësues N.K.

Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, procedurën e pranimit e shqyrton vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor ka kompetencën e plotë të shqyrtoj gjithë procesin dhe të shtrijë hetimin administrativ, e si rezultat i kësaj, vlerëson se personi i cili nxjerr vendimin e cekur si më lartë për shpalljen e konkurseve dhe vendimin e cekur si më lartë për themelimin e komisionit të pranimit, gjegjësisht Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, në këtë pozitë pune është emëruar me mandat katër (4) vjeçar, përmes Vendimit Nr.01/79, të nxjerrë nga mbledhja e datës 25.02.2022, e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes monitorimit të jashtëzakonshëm të bërë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me emërimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës përmes Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022, mbi të cilin akt ishte aprovuar Raporti i Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (*tani e tutje referuar: MFPT*), paraprakisht kishte konstatuar se emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese në shërbim civil, pa zhvilluar procedurat e rekrutimit, sipas dispozitave të aplikueshme ligjore gjegjësisht sipas përcaktimeve ligjore të nenit 40 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është tërësisht i kundërligjshëm, dhe shkel rëndë parimet e pranimit të zyrtarëve publik, të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili kishte qenë në fuqi asaj kohe, kështu që ishte rekomanduar edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e Vendimit Nr.01/79 të datës 25.02.2022, mbi të cilin e kishte emëruar Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës.

Ndaj Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 të Këshillit, ishte hapur konflikt administrativ nga kjo e fundit si institucion që kishte rekomanduar emërimin e Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës, mirëpo Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktvendimit me numër A.nr.1892/2022 të datës 22.08.2022 e ka refuzuar kërkesën e palës paditëse Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Këshillit A.nr.50/2022 të datës 14.07.2022, po ashtu kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Këshillit e kishte refuzuar edhe Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktvendimit me numër A.A.702/2022 të datës 27.09.2022, ndërsa është vërtetuar Aktvendimi me numër A.nr.1892/2022 i datës 22.08.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative.

Lidhur me vendosjen e çështjes meritore sipas padisë së MFPT, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023 e ka refuzuar padinë e palës paditëse-Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve nga rrjedh se Vendimi i Këshillit me numër A.nr.50/2022 i datës 14.07.2022 ka mbetur në fuqi pasi që është konstatuar ligjshmëria e tij, kurse po ashtu Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamentit për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër AA.nr.354/2023 të datës 08.07.2024 e ka refuzuar ankesën e palës paditëse-Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve duke vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kundër Aktgjykimit me numër AA.nr.354/2023 të datës 08.07.2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamentit për Çështje Administrative, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të shkallës së dytë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa përmes Aktvendimit me numër ARJ.nr.134/2024 të datës 25.09.2024 Gjykata Supreme e Kosovës e ka hedhur poshtë kërkesën e Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Mirëpo, pavarësisht rrethanave dhe fakteve të pasqyruara si më lartë se ndaj Vendimit të Këshillit ishte hapur konflikt administrativ, duke marrë për baze faktin se Vendimet e Këshillit ne procedurë administrative janë vendime të formës se prerë, Këshilli lidhur me moszbatimin e Vendimit me numër Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 përmes se cilit është konstatuar se emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme e ka njoftuar Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe Kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, në mënyrë shprehimore është njoftuar veçmas edhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës përmes shkresës së datës 03.10.2024 lidhur me mos zbatimin e Vendimit të Këshillit me numër Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Andaj, nisur nga fakti i pa kontestueshëm se të gjitha instancat gjyqësore të Republikës së Kosovës, kanë vërtetuar Vendimin Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin akt është vërtetuar konstatimi se emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendrorë të Punës, përmes Vendimit Nr.01/79, të datës 25.02.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i kundërligjshëm dhe shkel rëndë parimet e pranimi të zyrtarëve publik, dhe se me këtë rast Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokoli 2430 të datës 13.09.2024 i nxjerr nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës për shpalljen e konkurseve dhe Vendimi me numër protokoli 3049 i datës 18.11.2024 për themelimin e Komisionit të Pranimi për vlerësimin profesional të kandidatëve për konkursin për Inspektor të Punës, janë vendimet të pa ligjshme në kuptim të nenit 4 dhe 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: Neni 4 [Parimi i ligjshmërisë], ku përcaktohet se: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj. 3. Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte: 3.1. nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin; 3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe 3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore. 4. Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t’i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik”, Neni 52 [Paligjshmëria e aktit administrativ], ku përcaktohet se: “1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të

nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit”.

Bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektoratit i Punës, është i pavlefshëm ngase zyrtari kryesor administrativ, gjegjësisht Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës për aq kohë sa i njëjti është emëruar dhe është duke e ushtruar pozitën e punës në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të përcaktuara si më lartë, çështje kjo e vërtetuar edhe në të gjitha instancat gjyqësore, Kolegji i Këshillit konstatoi se çdo akt administrativ i nxjerrë nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës është akt i paligjshëm, për rrjedhojë edhe në rrethanat e rastit konkret Vendimi i datës 13.09.2024 për iniciimin e apo shpalljen e procedurave të rekrutimit si dhe Vendimi i datës 18.11.2024 për themelimin e komisionit të pranimit janë akte të paligjshme, ndërsa Kolegji i Këshillit meqenëse konstatoi se një akt i tillë është i kundërligjshëm si dhe akti i datës 18.11.2024 nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, pasi që të njëjtat nuk do të kishin ndonjë relevancë tjetër juridike dhe se ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar vetëm mbi konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa mbi këtë bazë rrjedhë se procedura nuk është zhvilluar në pajtim me parimet e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe parimet e pranimit në detyrë të zyrtares/it publik të përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 53 paragrafi 1 dhe 2, neni 55 paragrafi 1 ku përcaktohet se: **“53.1 Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj; 53.2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm; 55.1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë.”**, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi që të anuloi në tërësi procedurën e rekrutimit të shpallur përmes konkursit të datës 13.09.2024 me shifër RN00015136 për pozitën Inspektor i Punës, si dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga kjo procedurë, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës, obligohet që të nxjerrë dhe bëjë publik aktin e Njoftimit për anulimin e konkursit përkatës, sipas Vendimit të Këshillit A.nr.74/2025 të datës 27.02.2025.

Në rast të moszbatimit të Vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar si në dispozitivin e këtij Vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për zyrtarin përgjegjës, deri në zbatimin e Vendimit të Këshillit.

Kështu që për sa më sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.144/2025, datë 27.02.2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit F.Rr.;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*